

ANEKSI V

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

GARANCIA NR.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA (33,34% risk):

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP (33,33% risk):

INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP (33,33% risk):

16/0101/050332, Shtesa 1
2379, Shtesa 1 Seria 4177
017976/2017, Shtesa 1
Seria 18572

Bazuar në kërkesën e shoqërisë koncesionare "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K. datë 16.08.2018, kjo garanci ndryshon dhe do të zgjerohet si më poshtë:


**Për: Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
Tiranë, Shqipëri**

Duke qenë se:

- Shoqëria Koncesionare "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K.**, me adresë në: Rruga Dervish Hima, Hyrja Nr. 1, Apartamenti 71/1, Tiranë, Shqipëri, e identifikuar me NIPT Nr. L72031013B, është shpallur fituese në Procedurën Konkurruese "Për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, sipas Njoftimit të Fituesit Nr. 6392 Prot, datë 17.08.2017, të lidhur me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit (më poshtë referuar si "Autoriteti Kontraktor"); dhe
- Në Kontratën tuaj kërkohet lëshimi i një Sigurimi Kontrate në vlerën e specifikuar si më poshtë, si garanci për zbatimin në mënyrën e duhur dhe sipas afateve të parashikuara të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e testimit; dhe
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive të sigurimit "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" SH.A., dhe "SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE Group" SH.A. dhe "INTERSIG VIENNA INSURANCE Group" SH.A., Tiranë, Shqipëri janë dakord të lëshojnë këtë garanci.**

Deklarojmë se:

- Jemi garantuesit e kontratës së sipërpërmendur deri në shumën totale prej 12,824,330 EUR (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzetë e katërmijë e treqind e tridhjetë euro), shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë; dhe
- Marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni kërkesën e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëni argumentim të kërkesës, çdo shumë të papaguar nga shoqëria "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K., brenda kufirit prej 12,824,330 EUR (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzetë e katërmijë e treqind e tridhjetë euro) për çdo shkak të mundshëm, të matshëm, të provueshëm dhe jashtë kontrollit të shoqërisë "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K. duke gëzuar të drejtat e saj sipas kontratës dhe bazuar në nenin 1142 të kodit civil; dhe



- Për marrjen e kësaj garancie, nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë Koncesionarit për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj; dhe
- Asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të Kontratës, për të cilën ju mund të bini dakord me Koncesionarin, nuk na çliron nga detyrimet e kësaj Garancie, por Siguruesi duhet të njoftohet për çdo shtesë apo ndryshim të kontratës në përputhje me nenin 1144 dhe 1159 të kodit civil.

Kjo garanci është e vlefshme deri në **30 ditë nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit** të punimeve të ndërtimit (kryerja e testimit të veprës dhe vënies në punë të saj), duke paguar primin e sigurimit.

Lëshuar në Tiranë, më datë **07 Shtator 2018** në përputhje me Autorizimet e lëshuara nga Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve, mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 8081, datë 07.03.1996 "Mbi Veprimtarinë e Sigurimeve dhe Risigurimeve", ndryshuar me ligjin 52/2014 datë 22.05.2014. Kjo garanci nuk i kalon afatet ligjore të përcaktuara në kontratën që do të lidhet midis Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit. Kopje e kësaj kontrate pasi të firmoset do të dorëzohet te Siguruesi që t'i bashkëngjitet Garancisë. Primi i sigurimit është i përcaktuar sipas faturës bashkëngjitur dhe i pagueshëm me lëshimin e garancisë.

SIGURUESIT

ISIGURUARI

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.

INTEGRATED ENERGY BV SPV SH.P.K.

AVNI PONARI
Administrator i Shoqërisë

GIUSEPPE CIAFFAGLIONE
Administrator i Shoqërisë

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.

KLAIDI ÇITOZI
Administrator i Shoqërisë

INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.

GENTIAN SULA
Administrator i Shoqërisë
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS
Garancia nr.16/0101/050332

Për: Ministria e Mjedisit
Tiranë, Shqipëri

Duke qenë se:

- Shoqëria Koncesionare "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K.**, me adresë në: Rruga Dervish Hima, Hyrja Nr. 1, Apartamenti 71/1, Tiranë, Shqipëri, e identifikuar me NIPT Nr. L72031013B, është shpallur fitues në Procedurën Konkurruese Për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, sipas Njoftimit të Fituesit Nr. 6392 Prot, datë 17.08.2017, të lidhur me Ministrinë e Mjedisit (më poshtë referuar si "Autoriteti Kontraktor"); dhe
- në Kontratën tuaj kërkohet lëshimi i një Sigurimi Kontrate në vlerën e specifikuar si më poshtë, si garanci për zbatimin në mënyrën e duhur dhe sipas afateve të parashikuara të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e testimit; dhe
- Shoqëria e sigurimit "**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.**, me adrese ne: Qendra e Biznesit SIGAL, Blvd "ZOG I", nr.1,, Tirane, Shqiperi është dakord të lëshojë këtë garanci.

Deklarojmë se:

- jemi garantuesit e kontratës së sipërpërmendur deri në shumën totale prej 12,389,780 EUR (*pesëmbëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë euro*), shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë ; dhe
- marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni kërkesën e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëni argumentim të kërkesës, çdo shumë të papaguar nga shoqëria "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K., brenda kufirit prej 12,824,330 EUR (*dymbëdhjetë milionë e tetëqind e njezet e kater mije e treqind e tridhjetë euro*) për çdo shkak të mundshëm, të matshëm, të provueshëm dhe jashtë kontrollit të shoqërisë "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K. duke gëzuar të drejtat e saj sipas kontratës dhe bazuar në nenin 1142 të kodit civil; dhe
- për marrjen e kësaj garancie, nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë Koncesionarit për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj; dhe
- asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të Kontratës, për të cilën ju mund të bini dakord me Koncesionarin, nuk na çliron nga detyrimet e kësaj Garancie, por Siguruesi duhet të njoftohet për çdo shtesë apo ndryshim të kontratës në përputhje me nenin 1144 dhe 1159 të kodit civil.

Kjo garanci është e vlefshme për 12 muaj nga data e lëshimit dhe do të rinovohet me kërkesë të shoqërisë koncesionare deri në **30 ditë nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit** të punimeve të ndërtimit (kryerja e testimit të veprës dhe vënies në punë të saj), duke paguar primin e sigurimit.

Adresa: Qendra e Biznesit SIGAL, Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tiranë, Tel: (+355) 4 2233 308 / 2253 407 / 2253 408, Fax: (+355) 4 2250.220
Kutia Postare 2387, e-mail: info@sigal.com.al

Shoqëria Aksionere me NIPT J91809007H

Lëshuar në Tiranë, më datë **31 GUSHT 2017** në përputhje me Autorizimet e lëshuara nga Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve, mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 8081, datë 07.03.1996 "Mbi Veprimtarinë e Sigurimeve dhe Risigurimeve", ndryshuar me ligjin 52/2014 datë 22.05.2014. Kjo garanci nuk i kalon afatet ligjore të përcaktuara në kontratën që do të lidhet midis Autoritetit Kontraktor dhe Koncensionarit. Kopje e kësaj kontrate pasi të firmoset do të dorëzohet te Siguruesi që t'i bashkëngjitet Garancisë. Primi vjetor i sigurimit është i përcaktuar sipas faturës bashkëngjitur dhe i pagueshëm me lëshimin e garancisë.

SIGURUESI

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.

AVNI PONARI

Administrator / Shoqërisë

ISIGURUARI

INTEGRATED ENERGY BV SPV SH.P.K.

GIUSEPPE CIAFFAGLIONE

Administrator i Shoqërisë